

# YIHR-ja dhe QESH-i reagojnë ndaj kërcënimit të tre anëtarëve të QESH-it

PRISHTINË, 24 GUSHT - Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut (YIHR) si dhe Qendra për Emancipim Shoqëror (QESH) kanë reaguuar të enjten ndaj një kërcënimi të ushtruar kundër tre anëtarëve të kësaj qendre, për siç thuhet "orientimin e tyre seksual".

Sipas njoftimit të lëshuar, një pjesëtar i agjencisë së sigurimit "Black Panther" i ka kërcënuar të tre anëtarët e qendrës, të cilët kanë orientim alternativ seksual, për t'i nxjerrë jashtë klubit mbrëmjen e së mërkurës, derisa ata kanë qenë duke u argëtuar, me arsyetimin se me sjelljet e tyre ua shpifnin klientëve të tjerë të klubit qëndrimin e mëtejme atje.

Në kumtesë vihet në pah se derisa personat në fjalë kanë qenë duke vallëzuar me njëri-tjetrin, pjesëtar i sigurimit u ka thënë atyre se

do t'i largojë nga kafiteria me motivacionin se "vallëzimi i tyre ka qenë neveritës për njerëzit që ndodheshin përreth". Në të njëjtën kohë, thuhet në kumtesë, pjesëtar i sigurimit, u ka thënë atyre se gjestet si të tyret "nuk tolerohen" në atë lokacion.

Dy OJQ-të në reagimin e tyre vënë në pah se sjelljet e tilla i kontribuojnë mostolerancës dhe diskriminimit të mëtutjeshëm të minoriteteve seksuale, duke krijuar frikë brenda komunitetit homoseksual në Kosovë dhe shpresojnë se kompania do të marrë masa disiplinore ndaj punonjësit të saj ndërsa i kërkojnë autoriteteve që të parandalojnë diskriminimin e komuniteteve me orientime alternative seksuale duke vepruar në pajtueshmëri me Ligjin kundër diskriminimit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.